

KËRKESË
Nr. 2315/7, datë 13.6.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së madhe”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimin nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Për të gjitha pasuritë është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZVRPP-së”, për arsye të konfirmimeve jo të plota dhe jo të sakta lidhur me titujt e pronësisë. Për të gjitha këto pasuri do të rikërkohet konfirmim pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë. Në bazë të të dhënave përfundimtare do të hartohet lista përfundimtare, e cila do të propozohet për shpronësim pranë Këshillit të Ministrave.

Vlera totale e shpronësimit është 219 610 048 (dyqind e nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë e dyzet e tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi